



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, me 22 korrik 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Bojan Stojanovič, Naim Maloku, Melihate Termkollu, Gani Geci, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Agim Veliu, dhe Zulf Merxha.

Munguan: Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu. Agim Veliu,

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, Kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 09.07.2008**
- 3. Shqyrtimi i Rekomandimeve për situatën e sigurisë**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me piken e parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 09.07.2008

Kryesuesi, konstatoi se Procesverbali i mbledhjes së datës 09.07.2008, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Rekomandimeve për situatën e sigurisë

Siç e dini në mbledhjen e kaluar, kemi marr vendim që ne si komision të bëjmë disa rekomandime për situatën e sigurisë. Ne i kuptojmë vështirësitë me të cilat përballet ky sektor, por megjithatë Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe vet Parlamenti duhet të luajnë rolin e vet aktiv në këto procese. Para vetes keni një draft të këtyre rekomandimeve dhe hapi diskutimin për të.

Agim Veliu propozoi, që këto rekomandime ti lemë për mbledhjen e radhës, në mënyrë që të kemi pak kohë ta shqyrtojmë këtë material.

Melihate Termkoll tha, mendoj se duhet të bëhet një thurje më e gjerë për situatën aktuale të sigurisë dhe pastaj të kërkohet nga Qeveria se si është gjendja e sigurisë në Kosovë në mënyrë që këto të mos mbeten vetëm rekomandime por edhe të ndërmerren hapa konkret për zgjidhjen e situatave të tilla.

Zafir Berisha tha, pajtohem me parafolësen, por unë mendoj se ne jemi pak vonë me këto rekomandime, sepse kanë ndodh zhvillime në Kosovë të cilat e mbajnë situatën të tensionuar, prandaj mendoj se parlamenti duhet me pas një akt të vetin sa i përket situatës së sigurisë në Kosovë.

Gani Geci tha, pajtohem me parafolësit e mi dhe kisha deshtë që në këto rekomandime të hyjë edhe përkrahja e Kryetarit të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, për shkak të aktivitetit të tij dhe gjendjes së komplikuar që gjendet atje.

Me marrëveshjen e përbashkët të anëtarëve të komisionit u vendos që rekomandimet për Kryesin e Kuvendit të shtyhen për shqyrtim deri ne takimin e radhës me qëllim që anëtarët e komisionit ti sjellin edhe rekomandimet e veta.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë kryesuesi i mbledhjes përmendi disa çështje, ai tha se UNDP-ja ka organizuar një punëtori për projektligjin për armët, ju keni marr një draft-agjendë është java e parë e shtatorit, ka mbetur të caktohet vetëm vendi se ku do të mbahet dhe unë besoi se të gjithë ju do të merrni pjesë në këtë punëtori.

Çështja e dytë ka të bëjë me Raportin e Agjencionit Antikorrupsion, për të cilin unë mendoj se nuk është shumë i çart, prandaj kërkoj ta thërrasim në takim Drejtorin e Agjencionit pasi puna e këtij agjencioni është në fushëveprimin e komisionit tonë.

Gani Geci tha, nëse ne e thërrasim Drejtorin e Agjencionit mendoj se do ta frikësojmë, ne jemi këtu ta përkrahim dhe jo ta frikësojmë me sqarime të tilla.

Kryesuesi tha qëllimi i jonë nuk është ta frikësojmë, por raporti nuk është i çartë prandaj kërkoj ta ftojme vetëm ta dëgjojmë se si po punohet në këtë agjencion.

Shkumbin Demaliaj tha, unë mendoj se është mirë ta ftojme në një takim, sepse si komision ne kemi të drejt ta ftojme sepse ai na përgjigjet neve si komision dhe Kuvendit të Kosovës, prandaj do të ishte mirë të zhvillohet një takim.

Zafir Berisha tha, një takim s' do të prishë asgjë punë, njëkohësisht ne mund ti themi se e ka përkrahjen tonë për punë të mëtutjeshme. Mirëpo unë kërkoj ta di se çka u bë me Projektligjin për Sigurinë Private.

Kryesuesi tha se Kuvendi ka vendos që ky ligj të pushoj deri sa të vinë edhe ligjet tjera në mënyrë që të shkojnë në pako.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit